



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KRYETARI**

Nr. 154 prot.

Përmet, më 20/01 /2021

VENDIM

Nr. 08 Datë 20/01 /2021

**PËR
MIRATIMIN E KODIT ETIK TË BASHKISË**

Bazuar në nenin 64 pika j) të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,Ligji Nr.9131,date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”,Ligji Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”,i ndryshuar.Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.Ligji Nr.44/2015”Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.
Kryetari i Bashkisë,

VENDOSA:

- 1.Miratimin e Kodit Etik të Bashkisë Përmet bashkëlidhur këtij Vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Zyra e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Përmet,të gjitha Drejtoritë,Sektorët, Njësite Administrative dhe Institucionet e varësisë.
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË
ALMA HOXHA**



MIRATOI
KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA



KODI ETIK I BASHKISË PËRMET

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 89/2015 “Për veteqeverisjen vendore”
- Ligji Nr. 9131, date 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës me Administratën Publike”
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 7961 date 12.07.1995 “Kodi i Punës ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

KREUI

PARIMET BAZE

Neni 1

Vlerat individuale morale

Te gjithë nëpunësit janë të detyruar të respektojnë kushtetuten, ligjet dhe aktet e tjera nenligjore, si dhe parimet e etikës, të jenë të ndershëm e të paanshëm, të rritin efektivitetin e punës për të gjithë strukturat e shërbimit civil dhe të forcojnë besimin e mbështetjen e publikut ndaj tyre.

Punonjësit e bashkisë duhet të eliminojnë në jetën private sjelljet që kanë ndikim negativ në imazhin e tyre të krijuar në shoqëri, ose që lekundin besimin e publikut, bazuar në një administratë të paanshme, ligjore dhe profesionale.

Neni 2

Sjellja

Punonjësit e Bashkisë duhet të sillen në përputhje me parimet e etikës dhe brenda njohurive të tyre të përgjigjen publikut me saktësi, qartësi dhe kulturë për çdo paqartësi apo pakënaqësi që publiku paraqet ndaj tij ose bashkisë Përmet.

Neni 3

Transparenca

Punonjësit e Bashkisë brenda njohurive të tyre, i bëjnë të ditur publikut shërbimet që ai apo bashkia e tij kanë për detyrë të japin.

Neni 4

Efektiviteti

Punonjësit e Bashkisë shfrytëzojnë të gjitha aftësitë e tyre për kryerjen e detyrave shtetërore me maksimumin e efikasitetit dhe e përdorin kohën e punës vetëm për kryerjen e këtyre detyrave.

Neni 5

Respektimi i ligjit

Punonjesit e Bashkise veprimtarine e tyre e ushtrojne ne perputhje me kushtetuten, ligjet dhe aktet e nxjerra ne baze dhe per zbatimin e tyre. Punonjesit e bashkise duhet te perpiqen te shmangin ato sjellje apo veprime, te cilat krijojne pershtypjen se punonjesit po shkelin ligjin apo parimet e etikes.

Neni 6

Shmangia e konfliktit te interesave

Punonjesit e Bashkise duhet te bejne publike te gjitha investimet e tyre, interesat ne pasuri te paluajtshme dhe te ardhurat me qellim qe te parandalohet konflikti i interesave.

Neni 7

E drejta e informimit

Çdo person ka te drejte te informohet brenda afateve te parashikuara ne kete kod per dokumentet zyrtare qe kane te bejne me veprimtarine e bashkise dhe te punonjesve te saj pervec rasteve kur me ligj eshte parashikuar ndryshe.

Neni 8

Ndalimi i mitmarrjes

Punonjesit e Bashkise nuk duhet te kerkojne dhe pranojne nga askush si shperblim per kryerjen e e detyrave te tyre ne te shkuaren, ne te tashmen, ose ne te ardhmen, para ose sende te tjera me vlere monetare.

Neni 9

Rritja e profesionalizmit

Punonjesit e Bashkise duhet te kene njohuri rreth akteve ligjore dhe nenligjore, urdheresave dhe rolet e zyrtareve te zgjedhur dhe punonjesve te tjere bashkiake si dhe te procesit te zgjedhjeve bashkiak.

Neni 10

Rritja e besimit te publikut

Punonjesit e Bashkise duhet te punojne per rritjen e besimit te publikut ne qeverisjen qendrore dhe vendore duke vene te gjitha forcat dhe aftesite e tyre ne sherbimin e tij.

Neni 11

Raportimi shkeljeve

Punonjesit e Bashkise duhet te raportojne çdo rast vjedhjeje, korrupsioni dhe shkelje te ketij kodi prane zyres se burimeve njerezore
Te drejten per te raportuar shkelejt e mesiperme e kane dhe anetaret e keshillit bashkiak dhe qytetaret.

Neni 12

Zbartimi i kodit

Kodi etik i Bashkise Përmet duhet te njihet dhe te zbatohet nga te tere punonjesit e bashkise Përmet.